



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEQA"

NIË DEKADË UNIVERSITET

# UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEQA"





*Ne jemi universitet i ri,  
për një shoqëri të re,  
për një shtet të ri, por  
synimi është shekullor:  
dija e përdorur në të  
mirë të njerëzimit, më  
shumë se çdo vlerë  
tjetër, e bën njeriun më  
të lumtur.*

## **FJALA e REKTORIT**



## Shoqëria multikulturore me njeriun në qendër

I nderuar lexues,

Duke ndarë kohën tuaj të çmueshme për Universitetin tonë, do të kuptoni besimin dhe shpresat e studentëve, profesorëve, asistentëve dhe të administratës së UKZ-së për të krijuar një universitet të ri, modern, cilësor dhe në shërbim të shoqërisë.

Më 6 mars 2023 ne i mbushim dhjetë vite punë si UKZ. Janë dhjetë vitet e themelimit, vitet më prodhuese, me të cilat ne krenohemi, e shpresojmë do të krenohen edhe ata që do ta festojnë njëqind vjetorin e UKZ e tutje. Është një përgjegjësi kulmore për një shoqëri e për një shtet krijimi i institucioneve, në rastin tonë krijimi i UKZ. Kjo na rikthen te fara e krijimit, te gjeneza, po edhe na shpie rrugës së gjatë përpara.

Ne jemi universitet i ri, për një shoqëri të re, për një shtet të ri, por synimi është shekullor: dija e përdorur në të mirë të njerëzimit, më shumë se çdo vlerë tjetër, e bën njeriun më të lumtur.

Statusi i dijes në epokën e internetit dhe të botës virtuale ka ndërruar dhe po ndërron me shpejtësi të madhe. Kjo e afirmon dijen, por njëkohësisht, krijon mundësi për shpërdorimin e saj. Universiteti është rruga më e sigurt për ruajtjen e statusit të dijes në shërbim të njerëzimit. Universiteti është një mundësi e madhe për shoqërinë, me kusht që aty të kultivohet mendja e hapur e studentëve, të kultivohet mendimi kritik, të nxitet hulumtimi shkencor, por edhe të përgatiten për tregun

e punës. Vetëm me këtë qasje studentët tanë mund t'ia kthejnë borxhin shoqërisë, atdheut dhe mbarë botës: përmirësimin e mirëqenies sociale, zhvillimin ekonomik si dhe promovimin e garës duke respektuar konkurrencën. Vetëm me këtë qasje Universiteti ynë mund ta luajë rolin e dritares së shoqërisë: një dritare e hapur për të parë dhe për të komunikuar më shumë me botën.

Universiteti është rruga më e sigurt për të zbutur e zgjidhur dallimet dhe polarizimet e mëdha të botës bashkëkohore, ndër të cilat po përmend:

- *identitetet, kulturat, gjuhët dhe shoqëritë e vogla, përballë proceseve globaliste;*
- *vlerat e demokracisë përballë nevojave njerëzore për një jetë më të mirë;*
- *vlerat e demokracisë përballë paqes globale;*
- *kultura e konsumatorizmit përballë varfërisë ekstreme;*
- *kultura e ruajtjes së mjedisit dhe të ajrit përballë shpërdorimit të natyrës e të ajrit;*
- *digjitalizimi i dijeve dhe rreziku i krijimit të njeriut pa kujtesë ose gjysmanalfabetë;*
- *jeta virtuale dhe rritja e urrejtjes etj.*

Në një botë të trazuar nga dinamika e zhvillimeve virtuale dhe nga moskuptimet midis interesave globale dhe lokale, universiteti është gjeneratori i multikulturalizmit me njeriun në qendër. Ky është vizioni që na thërret.

Ne po synojmë një universitet të ri-për një epokë të re. Na priftë e mbara të gjithëve!

*Prof. Dr. Bajram Kosumi*

# Tradita e arsimit të lartë në Gjilan dhe themelimi i Universitetit Publik “Kadri Zeka”

- 1958, Qendra për Kualifikimin e Mësuesve (Shkolla Normale)
- 1973, Akademia Pedagogjike e Arsimit të Lartë
- 1980/81, Qendra për Arsimin e Lartë të Mësimdhënësve u transformua në Shkollë të Lartë Pedagogjike “Skënderbeu”
- 2003, Fakulteti i Edukimit (dega e Universitetit të Prishtinës)
- 2010, Fakulteti Ekonomik (dega e Universitetit të Prishtinës)
- 2010, Fakulteti Juridik (dega e Universitetit të Prishtinës)

Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan i themeluar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës më datë 6 mars 2013, është ndër universitetet e reja të Kosovës për promovimin e kërkimit akademik dhe shkencor. UKZ ka një rol dhe përgjegjësi të veçantë në avancimin dhe zhvillimin e pasurisë intelektuale, shkencore, artistike dhe kulturore të:

- **Rajoni i Gjilanit**  
(komunat: Gjilan, Kamenicë, Novobërdë, Ranillug, Viti, Partesh, Klllokot, Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit, Shtime)
- **Rajoni i Ferizajit**  
(komunat: Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit, Shtime, Shtërpçë)
- **Rajoni i Preshevës**  
(komunat: Preshevë, Bujanoci, Medvegjë)
- **Rajoni i Kumanovës**  
(Maqedonia e Veriut): Kumanova, Likova.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

No. 07/116  
 (datë 06.03.2011)

Në mbledhjet e secili 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit N004/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dhe në bazuar në vendin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për kushtet e përgjithshme administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrave e subjektuar dhe plotësimin me Rregulloren nr. 07/2011 dhe vendin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjet e sajës së datës 2011, vend:

**V E N D I M**

1. themelohet Universiteti Publik i Gjilanit si institucion i arimit të lartë,
2. Obligueshet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendosin (si procedurë për shpërbërje dhe miratim) Kuvendi të Kosovës,
3. Vendoset kyç në fuqi dhe në zbatim.

*(Signature)*  
 Kryeministri i Kosovës

- ku shpërbër:
- Zëvendës kryeministrit
  - në çfardo ministri kompetent
  - Sekretarin e Përgjithshëm të QK-së
  - Aktin e Qeverisë



Republika e Kosovës  
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministertsi za Obrazovanje, Nauku i  
 Tehnologji i Kosovës / Ministry of Education, Science & Technological  
 Development / Ministere - Nauka i Mbrojtje (College of the Ministry)

Nr. 055/0713

Datë: 15.11.2011

Mbasit të Arsimin, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbledhjet e secili 4, 21, 22 të Ligjit nr. 002/10 për administratën shkollore të Republikës së Kosovës, në mbledhjet e secili 4, paragrafi 2, të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe dhe në bazuar në vendin 4 paragrafi 1-4 të Rregullores nr. 02/2011 për kushtet e përgjithshme administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrave dhe 22-93 të 2011, në bazuar në vendimin nr. nr. 07/116, datë 06.11.2011, të kërkimit shpërbërje të Universitetit Publik të Gjilanit për propozimin e secilit të Universitetit Publik të Gjilanit, vend:

**V E N D I M**

Për miratim të Universitetit Publik të Gjilanit:

1. Universiteti Publik i Gjilanit emërohet me emrin Universiteti Publik "Kadri Zeka",
2. Vendoset kyç në fuqi dhe në zbatim.

A r r a t e s t i m

Në bazuar të dispozitave të lartpërmendura dhe vendimit nr. datë 06.11.2011 me nr. nr. 07/116 të Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Gjilanit për propozimin e secilit të Universitetit Publik të Gjilanit me emrin Universiteti Publik "Kadri Zeka", si vendoset në mënyrë të kërkimit vendoset:

Vendoset si drejtor:

1. Universiteti Publik të Gjilanit,
2. Sekretari i Ministrisë,
3. Zyren e sekretarit të përgjithshëm,
4. Departamenti i figur,
5. Aktin e



## **Misioni i Universitetit**

UKZ është tempull i dijes, i cili kultivon dashurinë njerëzore dhe afirmon parimet e konkurrencës lojale; përgatitë të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie moderne dhe globale, pjesë e një tregu më të gjerë sesa tregjet tradicionale të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë sonë; nxitë mendimin kritik dhe shpirtin e ndërmarrësisë.

## **Vizioni**

Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan është krijuar për të qenë në shërbim të dijes, të edukimit dhe të mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe të mbarë njerëzimit.

Universiteti ynë është mundësia më e mirë për krijimin dhe avancimin e vlerave themelore njerëzore, për secilën kohë dhe në çdo hapësirë.

## **Vlerat themelore**

- Barazia në kushtet për fitimin dhe gjenerimin e dijes, e cila reflektohet në mosdiskriminimin e askujt;



- Kreativiteti, i reflektuar në hapjen tonë ndaj ideve të reja dhe format e shprehjes, kureshtje intelektuale, gatishmëri për t'u ballafaquar me rreziqe dhe frymën sipërmarrëse;
- Integriteti, i reflektuar në aderimin tonë me standardet më të larta etike në sjelljen personale dhe profesionale, si dhe në angazhimin tonë për transparencën dhe llogaridhënien në qeverisje dhe në çdo gjë që bëjmë;
- Qëndrueshmëria, e reflektuar në angazhimin tonë të përbashkët për të udhëhequr me shembull në ruajtjen dhe mbrojtjen e interesit publik dhe në qasjen tonë ndaj planifikimit përgjegjës financiar;
- Ekselencia: Kërkojmë përsosmëri. E kuptojmë rëndësinë e të menduarit kritik, disiplinën dhe përgjegjësinë dhe presim standardet shumë të larta për veten dhe të studentëve tanë;
- Lidhja: Jemi një ekip i integruar. Funksionojmë rreth parimit të besimit, bashkëpunimit dhe lidhjes në disiplina tona të ndryshme dhe në të gjithë botën;



Studentët në  
Universitetin  
“Kadri Zeka”  
janë më  
premtues.

**Studentët e UKZ-së  
shpresa më e madhe  
për të ardhmen!**



Interesimi i studentëve për të ndjekur studimet në UKZ që nga themelimi e deri më tani, mbetet i kënaqshëm. Regjistrimi i studentëve është bërë sipas kuotave të caktuara nga MASHT, ku përgjatë viteve shohim se numri i studentëve konkurrues, në disa prej programeve ka qenë shumë më i madh se sa kuotat e pranimit.

Studentët	2023
Nr. total i studentëve të regjistruar (2013-2023)	8242
Nr. i studentëve aktivë gjatë vitit akademik	2487
Të diplomuar (2017- 2023)	1989
Mesatarja e kalueshmërisë	44.00 %
Braktisur studimet	4,6 %
Nr. mësimdhënës/studentë	49 (të rregullt) + 35 (të angazhuar) = 80:2487
Marrëdhënia mësimdhënës- student	1:31
Nota mesatare e studentëve	7.94

## Orientimi i studenteve nëpër fakultete

Të dhënat tabelare tregojnë se Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor mbeten programe të kërkuara. Interesimi i studentëve në programet master, Mësimdhënie në Gjuhë e Letërsi Shqipe e në veçanti për programin Mësimdhënie dhe Kurrikula për Arsimin Fillor, është shumëfish më i lartë sesa kuotat e përcaktuara. Gjithashtu në programin Shkenca Kompjuterike numri i të interesuarve për të ndjekur studimet është në rritje e sipër.



*Studentët pas mbrojtjes së temës së diplomës*



Niveli	Fakulteti	Programi	13/14	14/15	15/16
BSc	Edukim	Arsimi Fillor	114	64	108
BSc	Edukim	Arsimi Parashkollor	113	66	75
BSc	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	372	304	258
BSc	Ekonomik	Banka, Financa dhe Kontabilitet	188	202	177
BSc	Ekonomik	Menaxhment dhe Informatikë	152	154	137
BSc	Ekonomik	Marketing	100	110	66
BSc	Ekonomik	Menaxhment			
BSc	Ekonomik	Menaxhment dhe Ndërmarrësi			
BSc	Ekonomik	Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar			
BSc	Shkenca kompjuterike	Shkenca Kompjuterike		54	60
BSc	Shkenca aplikative	Matematikë Arsimore			
MA	Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike			
MA	FSHK/FJ/FEK	E-Qeverisja			
MA	Edukim	Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe			
MA	Edukim	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor			
MA	Juridik	Juridiko - Penal			
MA	Shkenca Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale			
MA	Shkenca Kompjuterike	E-Qeverisja			
Gjithsej			1039	954	881

16/17	17/18	18/19	19/20	20/21	21/22	2022/23	Gjithsejtë
144	126	121	105	120	43	40	985
78	78	77	47	80	35	30	679
270	255	233	217	178	151	88	2326
145	80	85	123	150			1150
							443
64	64	79					483
117	93	101	125				436
				85	71	68	224
					74	59	133
101	95	76	64	76	128	148	802
			22	36	20		78
	51	28	22				101
	60	45	37				142
					24	30	54
					26	30	56
					20	25	45
					21	6	27
					41	37	78
919	902	845	762	725	654	561	8242

## Numri i studentëve të diplomuar në nivelin baçelor dhe master

Që nga themelimi e deri më sot, kanë diplomuar 1989 studentë gjithsej. Prej tyre 717 studentë kanë diplomuar në Fakultetin e Edukimit, 634 në Fakultetin Ekonomik, 362 në Fakultetin Juridik, 177 në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, 45 në programin master E-Qeverisja, 44 në programin master Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike si dhe 10 të diplomuar në Fakultetin Shkenca Aplikative.

Fakulteti	Numri i studentëve të diplomuar
Edukim	717
Juridik	362
Ekonomik	634
Shkenca Kompjuterike	177
Shkenca Aplikative	10
Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	44
E-Qeverisja	45
Totali	1989



## Ceremonia e diplomimit



*Rektori Prof. Dr. Bajram Kosumi, gjatë fjalës në ceremoninë  
e diplomimit të studentëve*



Universiteti Publik “Kadri Zeka” Në Gjilan, në vitin 2017 ka organizuar ceremoninë e diplomimit të studentëve, ngjarje kjo që finalizon angazhimin universitar dhe që është një nga momentet më të veçanta në jetën e çdo studenti.







*Ceremonia e diplomimit*



## **Stafi i akademik dhe administrativ në Universitetin Publik “Kadri Zeka”**

Numri i stafit akademik të rregullt ka shënuar rritje nëpër vite. UKZ, për çdo vit ka rekrutuar kuadro të reja. nga 4 Profesor që ishin në themelim, aktualisht Universitetit Publik “Kadri Zeka” numëron 52 staf akademik të rregullt.

Gjithashtu edhe stafi administrativ, ka shënuar rritje për këto vite, nga 7 zyrtarë, tani administrata përbëhet nga 33 zyrtarë. Prej tyre janë krijuar edhe menaxherët e mesëm, si: dy drejtorë zyrash, 2 sekretarë fakultetesh dhe 4 udhëheqës të tjerë të zyrave.

## **Stafi akademik dhe administrativ 2023**

Profesorë në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	47
Asistentë në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	1
Ligjërues në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	1
Profesorë të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	12
Ligjërues të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	2
Asistentë të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	57
Zyrtarë Administrativ	33
<b>Gjithsej</b>	<b>153</b>



*Pamje nga ambientet e Universitetit*



## Akreditimi dhe riakreditimi institucional

Që nga viti 2014, UKZ ka kaluar nëpër disa procese të akreditimit dhe është vlerësuar për programe studimore dhe për akreditim institucional. Në të gjitha rastet UKZ është vlerësuar pozitivisht.

Akreditimi institucional	Akredituar	Ri akredituar	Riakredituar
I. Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan	01.10.2014 Deri / 30.09.2017	01.10.2017 Deri / 30.09.2021	30.09.2021 Deri / 30.09.2024



## **Akademik Fejzullah Krasniqi:**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” si tempull i dijes po përgatitë brezat e reja me dije teorike dhe empirike për tu bërë të aftë e të suksesshëm si për parashtrimin ashtu edhe për zgjidhjen e problemeve serioze profesionale dhe shkencore në pesë njësitë akademike të tij: Fakulteti i Edukimit, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Fakulteti i Shkencave Aplikative. Ai pati sukses të konsolidohet me personel akademik cilësor dhe po përgatitë kuadro meritorë për tregun e punës.

Gjetjet nga hulumtimet shkencore nga stafit akademik dhe studentët e UKZ, si aseti më i çmuar, janë publikuar në shumë revista shkencore ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë, ato janë vënë në shërbim të plotë të shoqërisë. Nga zemra urojmë përvjetorin e dhjetë me dëshirat që në rrugëtimin e vet Universiteti “Kadri Zeka” në Gjiilan të arrijë deri në majat më të larta akademike dhe shkencore!



*Pamje gjatë mbajtjes së takimit me ekspertë të akreditimit*

## **Ri/akreditimi i programeve studimore Baçelor dhe Master**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” gjatë periudhës 10-vjeçare ka shënuar progres në rishikimin e programeve studimore ekzistuese si dhe në hapjen e programeve të reja, në veçanti në programet e studimeve master. Në vitin 2017 janë akredituar 2 programe Master: Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike i cili ka funksionuar si program i përbashkët ndërmjet; UKZ, Gjilan/ F. Juridik, UUH, Prizren/ F. Juridik dhe UHZ, Pejë/ F. Juridik. Po ashtu, E- Qeverisja si program i përbashkët i tri fakulteteve të UKZ-së ; Shkenca Kompjuterike, Juridik dhe Ekonomik.

Në vitin 2019 është krijuar edhe Fakulteti i pestë në UKZ, Shkencave Aplikative, në kuadër të cilit është akredituar Programi Matematikë Arsimore Bsc.

Në vitin 2021 janë akredituar edhe 3 programe të reja master. Në kuadër të Fakultetit të Edukimit; Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe Mësimdhënie dhe Kurrikula për Arsimin Fillor kurse në kuadër të Fakultetit Shkencat Kompjuterike; Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale. Aktualisht, UKZ ka të akredituara 5 programe bachelor dhe 5 programe master, 10 gjithsej.

Fakulteti	Programi	Akredituar	Riakredituar	Riakredituar
<b>EDUKIMI</b>	Arsimi Parashkollor	01.10.2014 Deri/30.09.2016	01.10.2016 Deri/2020	30.09.2024
	Arsimi Fillor	01.10.2014 Deri/30.09.2016	01.10.2016 Deri/2020	30.09.2024
<b>EKONOMIK</b>	Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar	01.10.2014 Deri/30.09.2017	01.10.2017 Deri/2020	30.09.2024
	Menaxhim dhe Ndërmarrësi	01.10.2014 Deri/30.09.2016	01.10.2016 Deri/2020	Deri/30.09.2023
<b>JURIDIK</b>	Juridik i Përgjithshëm	01.10.2014 Deri/30.09.2016	01.10.2016 Deri/2020	Deri/30.09.2025
<b>SHKENCA KOMPJUTERIKE</b>	Shkencat Kompjuterike	01.10.2014 Deri/30.09.2016	01.10.2016 Deri/2020	30.09.2026
<b>SHKENCAT APLIKATIVE</b>	Matematikë Arsimore	1.10.2019 Deri/30.09.2022		

## Akreditimi dhe riakreditimi për studimet Master

Universitetet / Fakultetet	Programi	Akredituar	Riakredituar
1. UKZ, Gjilan/ F. Juridik 2. UUH, Prizren/ F. Juridik 3. UHZ, Pejë/ F. Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	01.10.2017 Deri/30.09.2021	
UKZ, Gjilan: 1. FSHK 2. Fakulteti Juridik 3. Fakulteti Ekonomik	E - Qeverisja	01.10.2017 Deri/30.09.2021	30.09.2024
Fakulteti i Edukimit	Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor	30.09.2024	
Fakulteti Juridik	Juridiko Penal	30.09.2024	
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale	30.09.2024	

## **Valentina Bunjaku-Rexhepi, deputete e Kuvendit të Kosovës:**

UKZ është universiteti më i rëndësishëm publik në Rajonin e Anamoravës dhe më gjerë, e sidomos adresë e studimeve për studentët shqiptarë të Luginës së Preshevës. UKZ ka ndihmuar sidomos vajzat e reja nga zonat rurale të Kamenicës, Vitisë e zonave të tjera, për të pasur mundësi më të lehta dhe më të mira për transport dhe kosto të përballueshme për të studiuar në Gjilan. Prandaj, UKZ mbetet një institucion që ka rritur numrin e vajzave për studime universitare dhe ka ndihmuar shumë studentët nga Lugina e Preshevës. UKZ është universitet me rëndësi jetike për Gjilanin, Anamoravën, Kosovën dhe Luginën e Preshevës, duke tejkaluar karakterin lokal. Në të gjitha aspektet, duhet të mbështetet e të promovohet. Pavarësisht kohës së re të themelimit si universitet dhe traditës së gjatë si Shkollë e Lartë Pedagogjike, mbetet një institucion shumë i rëndësishëm i dijes, edukimit dhe zhvillimit profesional të kuadrove të reja, sidomos prodhimit të kuadrove për në institucionet parashkollore dhe fillore.



## Kampusi dhe infrastruktura

- Kampusi i UKZ-së gjithsej (me kopsht) ka **2 ha** ose 20000 m<sup>2</sup>
- Kampusi ekzistues përbëhet prej dy objekteve të cilat janë të shënuara **Hyrja A** dhe **Hyrja B**, të ndërlidhura midis tyre (2021)
- Menaxhmenti i UKZ-së, Komuna e Gjilanit dhe Qeveria e Kosovës, planifikojnë **zgjerimin e kampusit aktual** ose ndërtimin e **kampusit të ri** në vend tjetër të qytetit të Gjilanit.
- Deri më tash, sado me disa përpjekje, Komuna e Gjilanit dhe MASHTI nuk kanë arritur të sigurojnë hapësirë për kampusin e ri të UKZ.

Më mungesë të kampusit të ri, UKZ ka rinovuar pjesë të ndryshme të kampusit aktual, duke e përshtatur me nevojat e studentëve, si janë për shembull, amfiteatrot dhe biblioteka.



*Amfiteatri B 01, i rinovuar*

### **Buxheti i UKZ-së ndër vite**

Universiteti Publik “Kadri Zeka”, kryesisht përdor dy mënyra të financimit:

1. Granti Qeveritar - janë para (buxhet) i siguruar nga Qeveria e Kosovës.
2. Të hyrat vetanake - këtu hynë:
  - Participimet e studentëve, pagesat e semestrave, vërtetimeve etj
  - Mjetet e siguruar nga pjesëmarrja e UKZ-së në projekte, kombëtare dhe ndërkombëtare (Erasmus+ ...).

Viti	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzimet komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzimet kapitale	Totali
2014	866,667.00	370,778.00	62,556.00	10,000.00	200,000.00	1,510,001.00
2015	1,044,413.00	349,161.00	50,000.00	10,000.00	370,000.00	1,823,574.00
2016	746,895.00	316,339.00	50,000.00	10,000.00	320,000.00	1,443,234.00
2017	930,214.00	316,339.00	50,000.00	10,000.00	250,000.00	1,556,553.00
2018	1,130,214.00	316,339.00	50,000.00	30,000.00	600,000.00	2,126,553.00
2019	1,297,642.55	316,339.00	50,000.00	100,000.00	600,000.00	2,363,981.55
2020	1,297,642.99	316,339.00	50,000.00	100,000.00	650,000.00	2,413,981.99
2021	1,297,642.99	400,000.00	50,000.00	100,000.00	240,000.00	2,087,642.99
2022	1,630,893.95	405,432.24	50,000.00	100,000.00	82,030.00	2,268,356.19
2023	1,535,281.00	476,923.00	50,000.00	100,000.00	150,000.00	2,312,204.00



## Cilësia dhe kontrolli i cilësisë

### **Dokumentet, Organet, Instrumentet për Vlerësim, Procesi i Vlerësimit dhe Raportet**

Sistemi i sigurimit të Cilësisë në UKZ është i bazuar në tri shtylla kryesore; Dokumente, Organe dhe Instrumentet për Vlerësim.

Në kuadër të mbikëqyrjes së sigurimit të cilësisë në UKZ janë paraparë një sërë aktivitete të cilat janë paracaktuar në Kalendarin Vjetor të Cilësisë. Lidhur me realizimin e aktiviteteve hartohet raport vjetor i cili diskutohet në Këshillin Mbikëqyrës për Cilësi edhe Vlerësim (KMCV).

Një ndër aktivitetet e rregullta është vlerësimi i brendshëm i cili realizohet përmes instrumenteve për vlerësim duke bazuar në Manualin për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së Stafit Akademik.

Gjithashtu për çdo vlerësim hartohen raporte të cilat u dorëzohen të gjitha palëve me interes.

Lidhur me sigurimin e cilësisë në UKZ organizohen takime të rregullta mujore me Koordinatorët e Cilësisë Si dhe takime dymujore me KMCV-në.



Dokumentet	Organet	Instrumentet për vlerësim	Procesi i vlerësimit	Raportet
1. Rregullorja për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin në UKZ Ref .nr.01/2280 Dt. 21/12/2020	1. Senati i UKZ	1. Pyetësor për vlerësim të SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semestër	1. Vlerësimi i SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semestrin dimëror	1. Raport për vlerësim të mësimdhënësve nga ana e studentëve për semestrin dimëror
2. Planin Strategjik të UKZ-së 2017-2020 e rishikuar në vitin 2020. Kapitulli 6. Pika 5	2. Këshilli Mbikëqyrës i Cilësisë dhe Vlerësimit	2. Pyetësori për vetëvlerësim të stafit akademik	2. Vlerësimi i SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semestrin veror	2. Raport për vlerësim të mësimdhënësve nga ana e studentëve për semestrin veror
3. Rregullore për themelimin dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës të Cilësisë dhe Vlerësimit ( KMCV). Nr.01/2124, dt.08.12.2020	3. Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi	3. Pyetësor për vlerësim Dekani-Mësimdhënësin	3. Procesi i Vetëvlerësimit nga Mësimdhënësit	3. Raport individual për secilin mësimdhënës
4. Manuali për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së Stafit Akademik, Nr. Ref. 01/2281 Dt. 21/12/2020	4. Komisioni i Studimeve	4. Pyetësor për vlerësim të Shërbimeve Administrative nga ana e studentëve	4. Vlerësimi Dekani-Mësimdhënësin	4. Raport individual për secilin mësimdhënës
6. Treguesit Kryesorë të Performancës në UKZ	6. Koordinatorët e Cilësisë nëpër njësi akademike	6. Pyetësor për vlerësim të programeve studimore nga Punëdhënësit	6. Vlerësimi i objektivave të caktuara nga SA në PZHI në fillim të vitit akademik	6. Raport individual për secilin mësimdhënës
7. Sistemi Evropian për transfer të kredive në Universitetin "Kadri Zeka", Gjilan		7. Pyetësor për vlerësim të programeve studimore nga studentët që diplomojnë	7. Vlerësimi i Programeve të UKZ-së nga Alumni	7. Raporti i vlerësimit nga rezultatet e hulumtimit me Alumni
8. Statuti i UKZ-së			8. Vlerësimi i UKZ-së nga punëdhënësit	8. Raporti i vlerësimit nga rezultatet e hulumtimit me punëdhënësit
9. Kalendarit Vjetor për Sigurim të Cilësisë në UKZ			9. Vlerësimi i Kalendarit Vjetor për sigurim të cilësisë	9. Raporti për realizimin e kalendarit vjetor të sigurimit të cilësisë



*Gjatë takimeve për koordinim të punëve për cilësi me stafin administrativ*



*Gjatë takimeve për koordinim të punëve për cilësi me stafin akademik*

### **Prof. dr. Bahtijar Kryeziu:**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” është një vatër e arsimit të lartë në Anamoravë, institucion i lartë i shumëpritur, që sot, më 13 mars 2023, po shënon 10-vjetorin e lindjes së tij.

Pata fatin që, pos punës sime mbi 43 vjeçare në Universitetin e Prishtinës, të kem një angazhim edhe në UKZ. Që në fillim kam parë elanin në punë të studentëve, të stafit akademik dhe të punonjësve të tjerë të këtij institucioni të lartë. Urime TEMPULLIT tonë të dijës 10-vjetorin e lindjes, kurse studentëve, stafit akademik dhe punonjësve të tjerë: gëzofshi shëndet e suksese edhe më të mëdha në punën e Juaj të shenjtë!

## MËSIMI ONLINE


Me shfaqjen e pandemisë Covid 19, UKZ iu kanë dashur vetëm dy javë që të përgatitet për ndërrimin komplet të sistemit të mësimdhënies: nga sistemi fizik në sistemin virtual.

Si pasojë e gjendjes së krijuar me pandeminë Covid-19, Universiteti “Kadri Zeka”, ka mundësuar zhvillimin e mësimit virtual, duke përdorur platformat SMU, meet. google.com; Google Classroom dhe platforma Moodle e UKZ-së e-learning.

Viti akademik	Mënyra e organizimit të mësimit	Periudha kohore
2019/2020	Online	20.03.2020 - 31.05.2020
2020/2021	Klasë	01.10.2020 – 01.11.2020
2020/2021	Online	02.11.2020 – 06.02.2021
2020/2021	Klasë	07.02.2021 – 16.03.2021
2020/2021	Online	17.03.2021 – 31.05.2021

Për periudhat e zhvillimit të mësimit virtual në UKZ janë mbajtur rreth 9,700 ligjëratave virtuale me një mesatare prej 58 ligjëratave në ditë.

<b>Numri i ligjëratave të mbajtura</b>	<b>9679</b>
<b>Numri i ligjëratave mesatare të mbajtura (Në ditë)</b>	58
<b>Kohëzgjatja mesatare e ligjëratës (Në minuta)</b>	44



*Foto gjatë mësimit online*

### **Kemajl Kurteshi:**

Urime për 10-vjetorin e punës së UKZ-së. Gjatë gjithë këtyre viteve, ju keni bërë shumë për të përmirësuar Universitetin tonë dhe ne do të jemi gjithmonë borxhli për brezat e ardhshëm, për të gjitha përpjekjet dhe vështirësitë tuaja. Faleminderit për 10 vjet shërbimin tuaj të përkushtuar.

## FAKULTETI I EDUKIMIT

**Fakulteti i Edukimit ka mision promovimin e arritjeve të studentëve, duke nxitur përsosmërinë arsimore dhe duke siguruar qasje të barabartë.**

Fakulteti i Edukimit ka këto programe të studimit:

1. Arsimi Fillor, baçelor, i akredituar deri në vitin 2024
2. Arsimi Parashkollor, baçelor, i akredituar deri në vitin 2024
3. Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, master i akredituar deri në vitin 2024
4. Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, master i akredituar deri në vitin 2024

Fakulteti i Edukimit synon përgatitjen e kuadrit të mësimdhënësve dhe edukatorëve në frymë bashkëkohore, aftësimin për t'u përballë me një botë, e cila vazhdimisht po ndryshon.

Këtu punohet në përgatitjen dhe ngritjen e mësimdhënësve dhe edukatorëve të rinj, duke sjellë përvoja të avancuara të vendeve perëndimore për aftësim profesional të mbështetur në praktikë dhe në krijimin e lidhjeve të natyrshme dhe të qëndrueshme midis fakultetit, shkollës dhe komunitetit arsimor.



*Sallë për aktivitete praktike për parashkollorët*

## **Pikat e forta të Fakultetit të Edukimit**

### **Organizimi dhe realizimi i praktikës pedagogjike**

Studentët e Fakultetit të Edukimit, të të dy niveleve, baçelor dhe master, praktikën pedagogjike e mbajnë në shkollat fillore dhe në çerdhet e rajonit të Gjilanit dhe të Ferizajit. Ky aktivitet praktik mësues realizohet në bashkëpunim me drejtoritë e arsimit, me drejtorët e shkollave dhe të çerdheve, si dhe me mësuesit dhe edukatorët, të cilët duhet t'i monitorojnë studentët gjatë tërë kohës sa janë në praktikë, proces i cili zgjatë varësisht prej viteve të studimit. Kështu studentët e vitit të dytë i mbajnë 4 javë, studentët e vitit të tretë i mbajnë 6 javë, ndërsa studentët e vitit të katër i mbajnë 8 javë praktikë pedagogjike. Ndërkaq, studentët e masterit në semestrin e dytë i mbajnë 3 javë të praktikës pedagogjike.

## **Punësimi i të diplomuarve në institucionet e arsimit**

Studentët të cilët kanë diplomuar në Fakultetin e Edukimit një pjesë e konsiderueshme e tyre tashmë janë punësuar qoftë si mësime dhënë në shkollën fillore, qoftë si edukatorë në institucionet parashkollore. Shumica e atyre që janë punësuar në vazhdimësi kanë treguar rezultate të shkëlqyeshme në performancën e tyre.

## **Organizimi i mësimi në studimet e nivelit master në dy programe**

Ndonëse aktualisht në Republikën e Kosovës vetëm fakultet e edukimit kanë të drejtë të nxjerrin kuadra të arsimit fillor dhe të mesëm, në kuadër të Fakultetit të Edukimit tashmë janë duke u aftësuar edhe studentët në nivelit master në dy programe si Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe në Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor. Vlen të theksohet se pos Universitetit “Hasan Prishtina” të Prishtinës, vetëm UKZ i ka të akredituara dy program në master.

## **Organizimi i aktiviteteve kulturore me komunitetin**

Fakulteti i Edukimit organizon aktivitete kulturore në bashkëpunim me komunitetin, si promovimin e librave; takimet me profesionistë nga fusha e arsimit, e shkencës dhe letërsisë; hapjen e ekspozitave të ndryshme.



## **Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka, prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte në UKZ:**

Universitetet në shekullin e XX dhe XXI kanë transformuar shoqëritë anë e mbanë globit, madje ato kanë transformuar edhe shtetet. Edhe Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka këtë rol për shoqërinë kosovare dhe jo vetëm. UKZ krijon vlera dhe kompetenca për të rinjtë e Kosovës në fusha të ndryshme të studimit, e të cilat janë thelbësore për zhvillimin e një shoqërie, siç është kjo e jona. UKZ po krijon kuadro të reja që po ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, ngritjen e cilësisë në arsim, drejtësi më të avancuar dhe më efikase, matematikan dhe ekspertë të IT-së, e të cilët në mënyrë direkte po ndikojnë në përmirësimin e standardit të jetesës së shoqërisë në Kosovë. Prandaj me të drejtë, të gjithë ne duhet të japim kontributin tonë për ta bërë UKZ-në një universitet me cilësi dhe me vlera evropiane. Madje këtë edhe e kemi obligim dhe mision për shoqërinë e këtij vendi, sepse në këtë mënyrë ne krijojmë për Kosovën një fuqi punëtore profesionale, me aftësi teknike dhe menaxheriale të larta, e të cilët në mënyrë të natyrshme do të sjellin edhe ndryshimet e nevojshme sociale, do të sjellin modernizim dhe patjetër do të sjellin edhe transformimin e shoqërisë sonë. Në këtë dekadë si Universitet – UKZ-së i uroj që të bëhet një Universitet që do të krijojë ekspertë në shumë fusha edhe për qindra e mijëra vjet. Gjilani dhe rajoni jonë më shumë se kurrë ka nevojë që të lidhet gjithnjë e më shumë me UKZ-në, sepse pikërisht këtu është e ardhmja e fëmijëve tanë – respektivisht shoqërisë tonë.

## FAKULTETI JURIDIK

**Fakultetit Juridik ka mision që studentët të bëhen juristë të mirë. Gurthemeli i Fakultetit Juridik është edukimi ligjor.**

Fakulteti Juridik dallohet me programe studimi të modeleve bashkëkohore me programet e saj, si:

1. Programi Juridik i Përgjithshëm – baçelor, i cili është i akredituar për 5 vite;
2. Programi E- qeverisja – master; program i përbashkët me tri fakultete të UKZ-së, Fakultetin Juridik, Ekonomik dhe Shkenca Kompjuterike, i akredituar deri në vitin 2024;
3. Programi Juridik penal - master; i akredituar deri në vitin 2024.

Fakulteti Juridik në Universitetin “Kadri Zeka” mbetet një prej zgjedhjeve më të mira për të rinjtë e komunës së Gjilanit dhe komunave tjera, si dhe studentët e Luginës së Preshevës dhe Maqedonisë Veriore.



*Një nga seancat simulative te studentëve të UKZ-së*



*Studentët duke bashkëpunuar*

## **Pikat e forta të Fakultetit Juridik**

- Studimet baçellor janë hartuar mbi bazën e trendëve të reja bashkëkohore, duke e lidhur teorinë me praktikë. Studentët e Fakultetit Juridik, në vitin e katërt e kryejnë praktikën profesionale një semestër nëpër institucione të drejtësisë.
- Herë pas herë në Fakultetin Juridik mbajnë ligjërata profesionistë që vijnë nga sfera e drejtësisë si: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, punëtorë socialë.
- Ka një interesim të lartë për t’u regjistruar në studimet e nivelit master Juridik Penal, ku vitin e kaluar kishte tre kandidat për një indeks, ndërsa një vit më herët proporcioni ishte 5:1.
- Profesorët tanë kanë treguar suksese të larta në publikimin e punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare. Brenda vitit akademik 2021/22 kanë publikuar 14 punime shkencore që janë të indeksuara në revista shkencore në Scopus dhe Web of Sciences.
- Profesorët tanë gjithashtu vazhdimisht marrin pjesë në konferenca shkencore, vendore, regjionale dhe ndërkombëtare.
- Në Konferencën e parë shkencore që organizoi UKZ, me 30-31 maj 2022, në Fakultetin Juridik janë paraqitur 45 pjesëmarrës me 66 punime.
- Ish-studentët tanë kanë treguar vazhdimisht sukses të lartë gjatë organizimit të provimit të jurisprudencës.
- Studentët e Fakultetit Juridik, pas përfundimit të studimeve bachellore kanë treguar suksese të larta në studimet e masterit dhe doktoratës në fakultetet juridike në Kosovë dhe jashtë saj.
- Juristët e diplomuar në Fakultetin Juridik, po tregojnë aftësi dhe shkathtësi profesionale. Këtë më së miri e ilustron suksesi i juristëve tanë të punësuar në gjykata dhe prokurori, veçanërisht në Gjilan, Viti dhe Kamenicë.

## FAKULTETI EKONOMIK

**Fakulteti Ekonomik ka mision zgjerimin e horizonteve për menaxhim me përgjegjësi shoqërore të sfidave të biznesit dhe ekonomisë.**

Fakulteti Ekonomik ka këto programe studimi të akredituara:

1. Programi Menaxhim dhe Ndërmarrësi – baçelor, i akredituar deri më 2023;
2. Programi Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar – baçelor, i akredituar deri më 2024;
3. Programi E-Qeverisja, master, program interdisiplinar me Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Fakultetin Juridik, i akredituar deri më 2024.

Fakulteti Ekonomik përmes rishikimit dhe reformimit të programeve studimore, ka për qëllim të arrijë nivelet më të larta të arsimit të lartë në rajon, përmes përgatitjes së menaxherëve, ndërmarrësve, ekonomistëve, kontabilistëve, financierëve kompetent për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë dhe tregut të punës.



*Organizimi i panairit të bizneseve nga UKZ*



*Ne mësojmë së bashku!*

## **Pikat e forta të Fakultetit Ekonomik**

Fakulteti Ekonomik ka reformuar programet studimore duke i përshtatur ato me tregun e punës dhe ka ndërruar standardin e evoluimit të vazhdueshëm të ofertës programore.

Fakulteti ka organizuar vizita të vazhdueshme studimore të studentëve nëpër biznese, ka dërguar studentë nëpër praktika profesionale si dhe një pjesë e mirë kanë gjetur vende pune.

Nga viti 2022, Fakultetit Ekonomik është pjesë e aktivitetit ndërkombëtar, Java Globale e Ndërmarrësisë. Studentët alumni të Fakultetit Ekonomik, kanë vazhduar të jenë të suksesshëm si në tregun e punës ashtu edhe në studimet pasdiplomike, si në vend ashtu edhe jashtë. Nga Fakulteti Ekonomik, tashmë kemi studentët të diplomuar në nivelin master në Universitetin e Sheffieldit, Fribourgut, Lubjanës, Tiranës etj.

Fakulteti Ekonomik, ka një staf të përgatitur dhe të kualifikuar i cili gjithnjë është në trend me zhvillimet e reja, ku gjysma e tyre kanë mbaruar doktoratat ose studimet master në programe në gjuhën angleze. Nga ta 5 janë profesorë të asociuar dhe 8 profesorë asistentë. Stafi i Fakultetit ka marrë pjesë të vazhdueshëm edhe në programet e trajnimit për kërkimin shkencor, metodat e reja të mësimdhënies, mobilitetit me universitete të tjera ndërkombëtare dhe në programet ndërkombëtare në kuadër të UKZ-së.

## **Aqim Emurli, udheheqes i ekipit Heras Plus.**

“Kam kënaqësinë të uroj Universitetin Publik ‘Kadri Zeka’ në Gjilan për 10 vjetorin e themelimit. Bashkëpunimi intenziv me udhëheqësinë e UKZ-së fillon prej vitit 2017 dhe përgjatë kësaj kohe kam vërejtur një përkushtim të madh nga ana e menaxhmentit për të punuar drejt zhvillimit të Universitetit, në drejtim të zhvillimit strategjik të universitetit, përmisimit të çështjeve qeverisëse dhe suksesit në fushën e ndërkombëtarizimit. Jam i lumtur që në një mënyrë apo tjetrën, Heras Plus ka qenë pjesë e këtyre sukseseve.”



## FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

**Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ka për mision ofrimin e ekspertëve të kompletuar në fushën e teknologjisë.**

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, ofron një bazë ndërdisiplinore, me studime të specializuar në dy fusha kryesore: Inxhinieri Softuerike dhe Web Design, si dhe Sistemet dhe Teknologjia e Kontrollit.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ka këto programe të akredituara:

1. Programi Shkenca Kompjuterike – baçelor, i akredituar deri më 2026;
2. Programi E- qeverisja – master, program i përbashkët me tri fakultete të UKZ-së, Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, Juridik dhe Ekonomik, i akredituar deri në vitin 2024;
3. Programi Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale – master, i akredituar 2024.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ofron njohuri themelore dhe të avancuara për sfidat teknologjike dhe softuerike në fushën e shkencave kompjuterike, si dhe zbatimin e tyre në industrinë e IT-së dhe të zhvillimit të softuerëve për Web dizajn dhe Ekonomi.



*Laboratori I- Shkenca Kompjuterike*

### **Pikat e forta të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike janë:**

- Krijimi i kuadrove të gatshëm për tregun e punës, shumë nga studentët tanë arrijnë që brenda nivelit të studimeve të kyçen në praktika dhe punë të ndryshme nga fusha e IT-së.
- Marrëveshje me Komunën e Gjilanit dhe Kamenicës për praktike të studentëve, gjatë së cilës ata do të krijojnë projekte që do ti shërbejnë komunës në digitalizimin e proceseve.
- Projektet e obligueshme të studenteve të vitit të tretë, të cilat i kushtohen komunitetit.
- Krijimi i platformës T-Edu, te e cila përfshihen të gjitha aktivitetet në lidhje me menaxhimin e mësimin, si: startimi dhe përfundimi i orës

mësimore, evidenca e studenteve, gjenerimi raporteve ditore, javore e mujore, materialet mësimore etj.

- Funkcionalizimi dhe përdorimi i vazhdueshëm i E-learning nga ana e profesorëve dhe studentëve
- Krijimi i mundësisë së akreditimit të programeve teknologjike të UKZ-së nga “The

Association of Technology, Management, and Applied Engineering (ATMAE)”, një agjenci homologe e AKA-së ne SHBA, e cila mbulon me akreditim gjithë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushën e teknologjisë, menaxhmentit dhe inxhinierisë aplikative.



*Laboratori II-Aktivitet i Klubit të IT-së*

## FAKULTETI I SHKENCAVE APLIKATIVE

**Fakulteti i Shkencave Aplikative ka mision edukimin aplikativ, duke i kushtuar kujdes vlerave njerëzore dhe qytetare, vlerave universale, si edhe përfitim të një kulture të gjerë akademike në mënyrën e gjykimit dhe reagimit ndaj situatave të shoqërisë bashkëkohore dhe dinamike.**



*Një nga laboratorët në UKZ-së*

Fakulteti i Shkencave Aplikative, me programin Matematikë Arsimore, niveli baçelor, është nevojë e domosdoshme, i cili do të përmbushë një nga detyrimet e arsimit të lartë në Kosovë, e që është përgatitja e

mësimdhënësve të matematikës në një frymë të re të zhvillimeve të arsimit. Në vitet e ardhshme do të vazhdojmë me programe të tjera aplikative, të cilat kanë për bazë matematikën dhe zbatimin e saj në tregun e punës në rajon dhe më gjerë. Fakulteti i Shkencave Aplikative përgatit profesionistë të gatshëm për tregun e punës dhe në shërbim të nevojave të shoqërisë së zhvilluar dhe prosperuese.

## **Pikat e forta të Fakultetit të Shkencave Aplikative**

Programi Matematikë arsimore ka përbushur një nga detyrimet e arsimit të lartë në Kosovë, e që është përgatitja e mësimdhënësve të matematikës në një frymë të re të zhvillimeve të arsimit matematik të përcaktuara nga ICME, ERME, ATEE etj. Në vitet e ardhshme do të vazhdojmë me programe të tjera aplikative, të cilat kanë për bazë matematikën dhe zbatimin e saj në tregun e punës.

Studentëve të shkëlqyeshëm u janë ndarë bursa nga:

- a. Universiteti Publik “Kadri Zeka”: 6 bursistë në vitin 2020 dhe 7 bursistë në vitin 2021,
- b. MASHT programi STEM: 27 bursistë në vitin 2021 dhe 22 bursistë në vitin 2022 dhe
- c. MASHT për studentë elitare: 5 bursistë në vitin 2022

## BIBLIOTEKA



*Njëra nga sallat e leximit në bibliotekë*

UKZ është i përkushtuar për ndjekjen e dijes, por edhe mban përgjegjësi për ofrimin e një baze shkencore për vetë-reflektim në shoqëri, duke kontribuar në masë të madhe në drejtim të zhvillimit të saj pozitiv, duke ofruar literaturë në bibliotekën e Universitetit si për stafin akademik po ashtu edhe për studentët.

Biblioteka e Universitetit “Kadri Zeka” ka një hapësirë rreth 500 m<sup>2</sup>, që shfrytëzohet mjaft shumë për lexim e literaturë.

Salla e bibliotekës është e përshtatshme për lexim dhe është relativisht e pasur me libra, ka gjithsej 45100 ekzemplarë. Prej këtyre shumica janë në gjuhën shqipe, por ka edhe në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera.

## **Xhelal Selimi – kryetar i Bordit Industrial të UKZ**

“Si kryetar i Bordit Industrial të Bizneseve të anamoravës në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, gjatë rrugëtimit tonë të përbashkët në mes të bizneseve dhe universitetit kemi kënaqësinë që edhe më tutje të vazhdojmë rrugëtimin, zhvillimin dhe hulumtimin në mes të dy institucioneve biznes-universitet për krijimin dhe avansimin e kuadrove të reja në interes të dy palëve me qëllim që ti përshtatemi ekonomisë dhe zhvillimit të regjionit të anamoravës. Kjo iniciativë është treguar viteve me radhë në panaire, punëtori dhe vizita të ndryshme të organizuara bashkërisht. Prandaj Anamorava dhe Gjilani si një nga qytetet më të zhvilluara në Kosove dhe me një ekonomi zhvillimore të avancuar dhe me një rini plot energji, vullnet dhe dëshirë për të arritur majat e studimit, 10 – vite më parë themeloi universitetin e qytetit të saj, universitetin “Kadri Zeka”, i cili u bë një simbol i qytetit të një universiteti që i kanë lakmi për metodat dhe kurrikulën e zgjeruar të drejttimeve duke plotësuar nevojën e studentëve të Gjilanit dhe regjionit për drejtimit e tyre të dëshiruara. Prandaj si regjion kemi nevojë që të ketë një lidhje të vazhdueshme biznes-universitet si një shembull i mirë që kjo lidhje ekziston edhe në Evropë dhe Amerikë për zhvillim të shoqërisë në përgjithësi. UKZ ka lehtësuar që ta kemi sa më afër njëri-tjetrin në cilësinë e punëdhënësit – punëmarrësit dhe ta kemi sa më të lehtë komunikimin tonë e mbi të gjitha të kemi kuadro të kualifikuara për tregun e punës. Urojë nga zemra universitetin për 10-vjetorin e themelimit me dëshirën për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtutjeshëm në të ardhmen”.

## PARLAMENTI STUDENTOR

Sipas Statutit të Universitetit “Kadri Zeka” interesat e studentëve përfaqësohen në kuadër të Universitetit me këto organe:

- Parlamenti i Studentëve në nivel të Universitetit
- Këshilli i studentëve në nivel të njësisë akademike

Parlamenti i Studentëve është organi më i lartë i përfaqësimit të studentëve. Numri i tërësishëm i anëtarëve të Parlamentit të Studentëve është 11.

Këshillat e studentëve janë organet e përfaqësimit të studentëve në secilën njësi akademike.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të secilit këshill të studentëve është 1 % e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në një njësi akademike, me më së paku 5 dhe më së shumti 21 anëtarë.

UKZ, në strukturën e saj ligjore ka paraparë përfaqësimin e studentëve në shumicën e organeve udhëheqëse të saj. Në Senat, Këshillin e Fakultetit, Komisionin për Studime dhe KMCV, përfaqësohen me 2 studentë, kurse në Këshilli Shkencor, Komisionin për Zbatim të Planit Strategjik dhe Këshillin e Etikës me nga 1 përfaqësues. Ndër aktivitetet e shumta që organizon Parlamenti Studentor janë edhe ushtrimet vullnetare për aplikuesit e rinj (maturantët) për provimin pranues.





*Studentët ushtrojnë maturantët*

Studentët e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, realizojnë aktivitetet për nder të festave të marsit.



*Studentët duke vendosur thëniet e tyre personale apo të zgjedhura nga autorë të ndryshëm*



*Recital i studentëve të UKZ-së për festat e nëntorit*

## DIPLOMA “STUDENT I DALLUAR”

Rektori i Universitetit “Kadri Zeka” çdo vit jep diplomën “Student i dalluar” për një studentët me notën më të lartë mesatare nga secili fakultet.

Në 10-vjetorin e themelimit, në hollin e universitetit, është vendosur tabela ku janë paraqitur emrat e studentëve të dalluar nëpër vite.

**Për vitin 2022/2023** kanë marrë diplomën “Student i dalluar”:

Fakulteti Edukimit - Albina Behluli

Fakulteti Juridik - Vlerë Avdiu

Fakulteti Ekonomik - Alena Shabani

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike - Dafina Keqmezi

Fakulteti i Shkencave Aplikative - Hekuran Salija

**Për vitin 2021/2022** kanë marrë diplomën “ Student i dalluar”:

Fakulteti i Edukimit - Elsa Karaliti

Fakulteti Juridik - Monika Hyseni

Fakulteti Ekonomik - Almedina Hyseni

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike - Erblina Qeli,

Fakultetit i Shkencave Aplikative - Dea Lota

Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike- Labinot Avdiu

E-Qeverisja - Donikë Hyseni

**Për vitin 2020/2021** kanë marrë diplomën “ Student i dalluar”:

Fakulteti i Edukimit - Arigoneta Shabija

Fakulteti Juridik - Besarta Sejdiu  
Fakulteti Ekonomik - Kudret Ibrahim  
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike - Vlera Bllaca

**Për vitin 2019/2020** kanë marrë diplomën “Student i dalluar”:

Fakulteti i Edukimit - Elitë Bardhi  
Fakulteti Juridik - Adelina Ajeti  
Fakulteti Ekonomik - Arbana Haliti  
Fakultetin e Shkencave Kompjuterike - Albionë Leci

**Për vitin 2018/2019** kanë marrë diplomën “Student i dalluar”:

Fakulteti i Edukimit - Rina Aliu  
Fakulteti Juridik - Verona Bektoshi  
Fakultetit Ekonomik - Albulena Bugaqi  
Fakultetin e Shkencave Kompjuterike - Ilir Nuredini

**Për vitin 2017/2018** kanë marrë Diplomën Student i dalluar:

Fakulteti i Edukimit - Ardhmërie Bajrami  
Fakulteti Juridik - Vjosë Avdiu  
Fakulteti Ekonomik - Astrit Agaj  
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike - Dritëlinda Hajdari

**Për vitin 2016/2017** kanë marrë diplomën “Student i dalluar”:

Fakulteti i Edukimit- Fatmir Kastrati  
Fakulteti Juridik- Teuta Gashi  
Fakulteti Ekonomik- Enis Rushiti  
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike - Arlind Hajdari



*Studentja Verona Bekteshi gjatë fjalës me rastin e marrjes së diplomës “Student i dalluar”*

## PËRSHTYPJET E STUDENTES SË FAKULTETIT JURIDIK, VERONA BEKTESHI

Përshtypjet e studentes së Fakultetit Juridik, Verona Bekteshi, së cilës Rektori Bajram Kosumi i dha diplomën “Student i Dalluar” në 6-vjetorin e themelimit, mars 2019.

Verona shprehet se janë pikërisht këto gjeste simbolike, ato që e rrisin motivin dhe dëshirën për të mësuar dhe ndikojnë në krijimin e qëllimeve për arritje të suksesit.

Ajo falënderon Rektorin Bajram Kosumi, stafin akademik për kontributin e dhënë, sepse siç thotë Verona, janë ata të cilët përveç të gjitha obligimeve tjera, në supet e tyre e mbajnë edhe peshën e rëndë të përcjelljes së njohurive dhe rëndësinë e shkollimit dhe edukimit.

Studentja e Fakultetit Juridik, Verona Bekteshi thotë se kualiteti i një Universiteti matet me cilësinë e studentëve që i nxjerrë dhe progresin, të cilin studentët e arrijnë gjatë viteve në studime, duke shtuar se Universiteti “Kadri Zeka” e ka dëshmuar në vazhdimësi se progresi është e vetmja rrugë që do ta ndjekë. Në vitin e gjashtë të themelimit, Verona ka uruar Universitetin “Kadri Zeka”, që të vazhdojë ecjen në rrugën e zhvillimit, e bashkë me Universitetin të rriten edhe studentët profesionalisht e personalisht.

## PRITJA E STUDENTËVE MË I TETOR



Në çdo fillim të vitit akademik rektori i Universitetit, prorektorët dhe dekanët e njësive akademike, profesorët, presin në mënyrë solemne studentët e rinj, si dhe familjarët e tyre.

Kjo bëhet për t'iu dëshiruar mirëseardhje studentëve të rinj në botën akademike universitare dhe për t'i udhëzuar ata më jetën akademike, me mësimin, ushtrimet, provimet dhe çështje të tjera akademike.



*Gjatë pritjes së studentëve me rastin e fillimit të vitit të ri akademik*

## PRAKTIKA DHE PROJEKTET E STUDENTËVE

Të gjithë studentët e Fakultetit të Edukimit, ndjekin praktikën nëpër institucionet shkollore dhe parashkollore. Praktika Pedagogjike është lëndë obligative e programeve Arsimi Fillor dhe Arsimi Parafillor.

Gjithashtu edhe studentët e Fakultetit Juridik ndjekin praktikën në Gjykatat e Rajonit të Gjiçanit, me të cilat UKZ ka marrëveshje bashkëpunimi.

Në kuadër të bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet tjera komunale e bankare, studentëve të Fakultetit Ekonomik u jepet mundësia e ndjekjes së praktikës profesionale.



*Gjatë monitorimit të studentëve të Fakultetit të Edukimit rreth mësimin praktik*

Studentët si përfitues të projekteve, kanë organizuar kampanjë kundër kopjimit.



*Gjatë organizimit të kampanjës kundër kopjimit*

Studentët certifikohen për “Pedagogji ligjore” nga punëtorja e organizuar nga Ohio Northern University, përkatësisht nga profesorët Howard Fenton dhe Kevin Hill.



*Foto nga organizimi i marrjes së certifikatave*



## **Ramadan Dërmaku, drejtor i shkollës fillore “Musa Zajmi” ne Gjiilan:**

Universiteti Publik “Kadri Zeka“ është vatër e zhvillimit dhe avancimit të njohurive profesionale, me potencial arsimdashës dhe zhvillim kurrikular për tregun e punës, duke treguar kujdes drejtë profesionalizmit me kapacitete të larta në studimet baçelor dhe atë posdiplomike, në drejtime të ndryshme , arsimore dhe profesionale! Me orientim dhe bashkëpunim edhe me shkollat, duke forcuar dhe zhvilluar edhe praktikën profesionale në fusha të caktuara me përkujdesje ndajë studentëve të universitetit dhe bashkëpunimit me menaxhamentin e shkollës! Urojmë suksese dhe profesionalizëm të thellë drejtë një Zhvillimi bash kohor me orientim të drejtë kurrikular drejtë tregut të punës! Urime 10 vjetori i jetës së universitetit, te jetojë me shekuj! Me moton zhvillim profesional dhe hulumtim shkencorë për të ardhmen e studentëve!



*Studentja Albionë Leci dhe krijimi i saj*



*Studentët gjatë marrjes së certifikatave*

Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Universitetit “Kadri Zeka” Liridon Halimi, Fatmir e Ilir Nuredini kanë realizuar projektin “Digjitalizimi i sallave të mësimiit në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike”.



*Studentët të cilët kanë realizuar projektin e digjitalizimit të sallave*

Studentët e UKZ, përveç aktiviteteve akademike organizojnë apo janë pjesëmarrës edhe të aktiviteteve të tjera kulturore.

Studentët dhe udhëheqësit e Parlamentit Studentor të UKZ-së, Adrian Bajrami, Dritor Mehmeti dhe Blerinë Ajvazi, kanë përfaqësuar Republikën e Kosovës në Samitin për Paqe në Republikën e Koresë Jugore, duke u bërë dhe anëtarë e IPYG (International Peace Youth Group).



*Studentët e UKZ-së në IPYG KORE*

Studentët e UKZ-së marrin pjesë edhe në gara sportive. Gjatë përfaqësimit në garat e Kampionatit të “Beach Volley” organizuar nga FSUK (Federata e Sporteve Universitare) Kosovë, Universiteti “Kadri Zeka” u nderua me vendin e parë në kategorinë e meshkujve.



*Studenti i UKZ-së Ermal Maliqi i pari në garat “Beach Volley” organizuar nga FSUNK*

## ANËTARËSIMI I UNIVERSITETIT NË FORUME NDËRKOMBËTARE

UKZ është anëtar themeluesi i Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, që është themeluar më 31 maj 2016. Konferenca e Rektorëve është organ këshillëdhënës, që ndihmon MASHT-in në orientimet e politikave programore të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), në planifikimin, koordinimin dhe harmonizimin e planit buxhetor të këtyre institucioneve me Departamentin e Arsimit të Lartë, caktimin e kriterëve për formulën e financimit të IAL në bazë të performancës së treguar, funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të informatave në institucioneve arsimore.

Kjo trupë ndihmon, po ashtu, edhe në harmonizimin i IAL dhe MASHT në planifikimin për numrin e regjistrimeve të reja të studentëve, orientimin e bursave studimore për studentët dhe aspektet tjera organizative të përgjegjësive të përbashkëta.



*Rektori Bajram Kosumi është zgjedhur kryetar i Konferencës së Rektorëve të Kosovës*

UKZ është anëtare e këtyre forumeve:

- Forumi Rektorëve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor
- Konferenca e Rektorëve të Universiteteve Publike Shqiptare
- Forumi i Rektorëve të Universiteteve Publike të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës
- Asociacioni Evropian të Fakulteteve Juridike (European Law Faculties Association-ELFA).
- MBR e SDSN- Rrjeti i Zhvillimit të Zgjidhjeve të Qëndrueshme
- Asociacioni i Universiteteve Ballkanike (BUA)
- Rrjeti Evropian për Integritetin Akademik (ENAI)
- Fondacioni evropian i Universiteteve (EUF)
- Asociacioni i Mësimdhënësve të Evropës (ATEE)
- Universiteti Publik “Kadri Zeka” pjesë Rrjetit Kombëtar për Hulumtim dhe Edukim KREN
- Federata e Sporteve Universitare
- Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Gjermano-Kosovare



*Foto nga takimi mes UKZ dhe Delegacionit gjermano – kosovar*

Rektori Kosumi është pjese aktive edhe në forume të tjera ndërkombëtare, kulturore e politike. Në Konferencën e Leadershipit Ballkanik të Federatës Universale të Paqes, mbajtur në Tiranë, anëtar i së cilës është edhe rektori i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, Prof. Dr. Bajram Kosumi, njëherësh ish-kryeministër i Republikës së Kosovës, i cili është laureuar me medaljen e paqes.



*Konferenca e Lidershit të Ballkanik të Federatës Universale të Paqes: Rektori Prof. Dr. Bajram Kosumi, ish kryeministër i Kosovës, Vilson Ahmeti, ish-kryeministër i Shqipërisë, Jakup Krasniqi, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, Zhivko Budimir, ish-president i Bosnjës e Hercegovinës, Alfred Moisiu, ish-president i Republikës së Shqipërisë, Zoran Zivković, ish-kryeministër i Serbisë, Fatmir Sejdiu, ish-president i Republikës së Kosovës dhe Stjepan Mesić, ish-president i Kroacisë*



## ZYRA PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR DHE PROJEKTE

Universiteti Publik “Kadri Zeka” mbetet i përkushtuar në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes në projekte, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe zhvillimit akademik të stafit akademik, administrativ dhe studentëve.

Në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Universitetit Publik “Kadri Zeka” janë arritur rezultate të mëdha dhe të rëndësishme në fushën e bashkëpunimit dhe projekteve në programe të ndryshme që ofron Bashkimi Evropian dhe organizata të tjera.

Bashkëpunimi Ndërkombëtarë në UKZ ka të rregulluar strukturën organizative e cila mbështetet në Infrastrukturën Ligjore të UKZ, Marrëveshjet e Bashkëpunimit, Projektet ndërkombëtare si dhe Anëtarësimet në Organizata Ndërkombëtare.

Universiteti ka nënshkruar 40 marrëveshje bashkëpunimi me Universitete tjera (Jashtë dhe Brenda Kosovës), 45 marrëveshje bashkëpunimi me Biznese, 11 marrëveshje me ICM si dhe 11 marrëveshje tjera me Institucione të ndryshme.

UKZ ka qenë partner në 18 projekte ndërkombëtare, kurse në projektin QUADIC ka qenë koordinator. Vlen të theksohet se përmes projekteve është zhvilluar mobiliteti si nga ana e stafit akademik, stafit administrativ, po ashtu edhe studentëve.



Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, janë disa studentë dhe staf akademik, që kanë fituar bursë studimore si pjesë e aktiviteteve universitare me karakter ndërkombëtar. Një shifër e përgjithshme: sa studentë të UKZ kanë shkuar në shkëmbim. Nder ta janë: Lizë Rexhepi, Xheneta Vranovci, Naxhije Rexhepi, Erlëta Halimi, etj.



Studentja Lizë Rexhepi

Studentja e Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan Lizë Rexhepi e cila ka fituar bursë të plotë për të përfunduar magjistraturën në njërin ndër të universitetet më prestigjioze në regjionin e mesëm të Shteteve të Bashkuara, Ohio Northern University Pettit College of Laë, në programin, Qeverisje Demokratike dhe Sundim

të së Drejtës dhe programin Pedagogji Ligjore. Ajo shprehet se është mjaft e gëzuar dhe ka një rëndësi të veçantë, si në pikëpamjen personale ashtu edhe profesionale si studente e Universitetit Kadri Zeka.

Sipas Lizës, rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në vazhdimin e studimeve në Amerikë me bursë, ka pasur Universiteti “ Kadri Zeka”, nga i cili ka përfituar dituri dhe njohuri të cilat sot e kanë ndihmuar të vazhdojnë tutje dhe të përfitojë këtë bursë.

Programi i kësaj burse është ekskluzivisht për studentët shembullor të cilët si qëllim kanë përgatitjen e tyre për t’u bërë profesor në Fakultetin Juridik në të ardhmen, prandaj Liza shpreson se eksperiencën që do ta fitojë atje, ta sjellë në Universitetin “ Kadri Zeka”.

Rreth 15 studentë të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të UKZ-së, kanë marrë pjesë në punëtorinë për zhvillim të moduleve inovative, në kuadër të projektit REBUS, pjesë e të cilit është UKZ, e cila punëtori ka zgjatur 15 ditë dhe është mbajtur në Graz të Austrisë.



*Gjatë vizitës së studentëve të UKZ-së në Graz*

## BASHKËPUNIMI UKZ-PH ZUG

Si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit që Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka me Universitetin e Zug-ut të Zvicrës, që nga viti 2016 e deri më tani, çdo fillim vit akademik, realizohen vizita studimore nga studentët dhe stafi i UKZ në PH Zug dhe anasjelltas.

Në këto vizita rreth 20 studentë nga UKZ dhe PH Zug kanë mundësi të shkëmbejnë përvojat dhe praktikat e tyre studimore nëpër universitetit përkatëse. Gjatë vizitave të ndërsjella, studentët qëndrojnë nëpër familjet shqiptare respektivisht zvicerane, për të mësuar më shumë për sistemin arsimor, për kulturën, për traditat dhe në përgjithësi për jetën që zhvillohet në të dy shtetet.



*Studentët e UKZ-së dhe ZUG gjatë aktiviteteve të përbashkëta në Zvicër*



*Studentët e UKZ-së dhe ZUG gjatë aktiviteteve të përbashkëta në Zvicër*



*Studentët e ZUG-ut në UKZ gjatë një ligjëratae*

## UKZ NXIT BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR

Universiteti “Kadri Zeka” në bashkëpunimin ndërkombëtar promovon shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik.

Universiteti Publik “Kadri Zeka” pjesë e programeve për mobilitet të studentëve:

- Manisa Celal Bayar University, Manisa-Turkey
- Nova Lisboa, Lisbonë, Portugali
- Universiteti “Angel Kancev”, Ruse, Bullgari
- Universiteti i Mariborit, Maribor Slloveni
- Projekti QUADIC- Universiteti “Kadri Zeka”
- Projekti QATEK- Universiteti i Prishtinës
- Projekti ResearchCult- IBCM
- Projekti ENEMLOS Universiteti i Podgoricës
- Projekti SMAHPC- Kolegji Heimerer
- Projekti eVIVA- UET
- Projekti REBUS- Universiteti i Sarajevës
- Projekti EUFORIA- Staffordshire University
- Projekti GreenTech Universiteti i Vigos
- Projekti SIAHDPC- Heimerer College
- Projekti STEAMedu- Universiteti i Mostarit
- Projekti STAND- IBCM
- Programi Fullbright- Ambasada Amerikane
- Projekti LECU- Qeveria zvicerane
- Projekti SHPRESE- Caritas Zviceran
- Projekti KODE- Banka Botërore
- Projekti OPTIMA
- Projektet me GIZ- 3 projekte
- Projekti “UP TO YOUTH” USAID
- Projektet e studentëve në fushën e digjitalizimit/UKZ
- Projektet me HERAS- 3 projekte ËUS Austria
- Projekti me HERAS- ËUS Austria
- ICM Erasmus+ -MCBU 2019
- ICM Erasmus+ -MCBU 2020
- CM Erasmus+ -Nova Lisboa 2020
- Projekti me US Alumni- US Alumni Association/Ambasada Amerikane

## ALUMNI

Rrjeti Alumni i Universitetit “Kadri Zeka” ka në fokus mbarëvajtjen profesionale të studentëve që kanë kryer studimet në Universitetin “Kadri Zeka” dhe ndërlidhjen e tyre. Nëpërmjet takimeve dhe aktiviteteve, ndihmon në transmetimin e ideve, nismave, inovacionit, bashkëpunimeve midis njëri- tjetrit, të cilat janë më se të nevojshme pas procesit të diplomimit dhe sidomos gjatë përballjes me tregun e punës.

Qëllimi i këtij shërbimi është lidhja e të gjitha gjeneratave të studentëve të UKZ-së, për të krijuar bashkëpunim të vazhdueshëm dhe krijimin e lidhjeve në mes të diplomuarve, profesorëve të fakulteteve përkatëse, bashkësisë më të gjerë akademike dhe punëdhënësve.

Alumni u krijua si një laborator i qasjes së studentëve të tij (punëkërkuësve) dhe formimit të tyre akademik me kërkesat e tregut të punës (punëmarrësve).

Studentët Alumni kanë marrë pjesë në dizajnimin e programeve studimore të UKZ-së, në dizajnimin e dokumenteve strategjike, siç është Strategjia Zhvillimore, Plani i Veprimit, etj.





### *Studentët Alumni gjatë dizajnit të programeve studimore*

Zyra për Alumni bën hulumtime të aktiviteteve dhe të arriturve të ish studentëve tanë, mbi baza të rregullta kohore. Me poshtë po japim një tabelë që tregon lëvizshmërinë e tyre pas përfundimit të studimeve në UKZ-së dhe rrugëtimin akademik të studentëve Alumni.

Jam punesuar në sektorin shtetëror-publik	3.82%
Jam punesuar në sektorin joqeveritar (OJQ)	3.82%
Jam punesuar në sektorin privat – në fushën e studimeve	11.45%
Jam punesuar në sektorin privat – në fushë tjetër	17.56%
Jam punesuar në biznes familjar	3.05%
Kam hapur biznesin tim	3.82%
Kam dalë jashtë shtetit-jam punesuar në fushën e studimeve	0.76%
Kam dalë jashtë shtetit-jam punesuar jo në fushën e studimeve	1.53%
Kam dalë jashtë shtetit-jam i papunë	0.76%
Jetoj në Kosovë i papunë	46.56%
Tjetër (Specifiko)	6.87%

### *Lëvizshmëria e studentëve Alumni*



vazhduar studimet master ne UP	37.80%
vazhduar studimet master ne Kolegj Privat ne Kosove	14.17%
vazhduar studimet master ne universitet rajonal	5.51%
vazhduar studimet master ne universitet perendimor	3.15%
Tjeter (specifiko)	39.37%

### *Rrugëtimi akademik i studentëve Alumni*



*Drita Haliti*

*Drita Haliti, studente e diplomuar në Fakultetin Ekonomik, në drejtimin Banka, Financa dhe Kontabilitet. “Pasi diplomimit me sukses të shkëlqyeshëm, kam ndjekur praktika dhe trajnime të ndryshme, gjithashtu jam në përfundim të studimeve master në Universitetin e Prishtinës, gjë që më ndihmuan në përgatitjen për tregun e punës. Aktualisht punoj në kompaninë “Albimi LTD”, si asistente e drejtorit të financave, në Departamentin e Financave dhe Kontabilitetit. Synimi im, sigurisht që është avancimi i mëtutjeshëm”.*



*Donika Ukshini*

*Donika Ukshini, e diplomuar në Universitetin Publik “Kadri Zeka”Gjilan, Fakulteti i Edukimit, programi Arsimi Fillor.” Kam ndjekur trajnime të ndryshme të cilat më kanë ndihmuar në zhvillimin profesional. Tani jam punësuar në shkollën fillore “Hello Academy of Education”,si mësimdhënëse e ciklit klasor”.*



*Buen Bajrami gjatë viteve 2014 – 2017 ka studiuar Shkencat Kompjuterike niveli baçelor në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan. Derisa gjatë vitit 2015 – 2016 në kuadër të projektit Erasmus Mundus Green Tech, Buen Bajrami, si student i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Universitetin “Kadri Zeka”, ka përfituar një bursë një-vjeçare për të studiuar në Paderborn të Gjermanisë. Bueni në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan ka ndjekur dhe përfunduar studimet e nivelit Master E – Qeverisja. Kurse në Konferencën e Parë DiGiDay të Universitetit “Kadri Zeka”, maj 2019, ka marrë certifikatë për prezantimin e punimit “Digitalizimi i bibliotekës shkollore“. Bueni*

në vitin 2021 ka regjistruar dhe Masterin e dytë në Universitetin “Kadri Zeka”, me titull “Sistemet e kontrollit dhe inteligjenca artificiale”. Gjithashtu gjatë vitit 2022 ka regjistruar edhe studimet e doktoratës në fushën e ngushtë “Sisteme kontrolli dhe inteligjence artificiale”. Bueni gjithashtu nga viti akademik 2020/2021 e tutje ushtron pozitën e asistentit pranë Fakultetit të shkencave kompjuterike në Universitetin publik “Kadri Zeka”.

Aktualisht është duke punuar në kompaninë e tij ENTECH Systems e cila merr përgjegjësinë për sistemet e komunikimit dhe sigurisë në të gjitha qytetet e Kosovës.

Kompaninë në fjalë Bueni e ka hapur dhe e drejton vet, menjëherë pas përfundimit të studimeve në shkencat kompjuterike në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan.

**“Studimeve në Universitetin ‘Kadri Zeka’ i gëzohem shumë, sepse sukcesi im është një shembull i mirë edhe për të tjerët që me studimet në UKZ dhe me punë arrihet shumë”.**

## **Mujë Tafa, drejtor i gjimnazit “Kuvendi i Lezhës” në Viti”**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” ishte dhe do mbetet institucion nga më i rëndësishmi për të gjitha shoqëritë, e në këtë rast për shoqërinë, shtetin dhe kombin tonë.

Një institucion si universiteti “Kadri Zeka” përmban vlera intelektuale dhe përgatitë gjeneratat e reja në perspektivë. UKZ është njëra nga mundësitë më të mira që vizioni i çdo të riu të realizohet suksesshëm dhe me perspektivë drejt të një të ardhme të ndritur.

# KONFERECAT

## Konferenca vjetore shkencore e UKZ-së

Konferenca Vjetore Shkencore Ndërkombëtare “Identiteti Shkencor dhe Kreativiteti në një Botë të Ndryshuar”, ka mbledhur personalitete të njohura nga shkencë si Akademikë, profesorë universitar nga universitete të njohura si Riga (Letoni), Barcelona (Spanjë), Izmiri (Turqi), Universiteti i Qipros etj., por edhe profesorë dhe studiues të rinj nga vendi, rajoni dhe Evropa.

Po ashtu jepet Çmimi i Konferencës Vjetore të UKZ-së “Marin Barleti” i cili i dedikohet arritjeve akademike në arsimin e lartë, kontributeve thelbësore kërkimore, çështjeve të reja, ideve, bashkëpunimit dhe perspektivave ndërkombëtare.



Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Identiteti shkencor dhe kreativiteti në një botë të ndryshuar” maj 2022

## Konferenca

### “Shkollat fillore një apo më shumë mësues”

Projekti i UKZ-së i krijuar në bashkëpunim me GIZ dhe MASHT, “Shkollat fillore një apo më shumë mësues”, është zgjeruar implementimi i këtij projekti edhe në shkollat tjera në komunën e Gjilanit dhe më gjerë. Ky projekt ka filluar që nga viti 2014, i cili është aktual edhe sot.



Konferenca për projektin “Shkollat fillore një apo më shumë mësues”

## Konferenca DiGiDay 2019

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ka organizuar Konferencën *DiGiDay 2019*, në bashkëpunim me Universitetin e Podgoricës, Universitetin e Korçës “Fan S.Noli”, Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Universitetin e Shkupit “Nënë Tereza”, Universitetin e Vlorës “Ismail Qemajli” dhe Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.



*Gjatë konferencës DiGiDay 2019*



## **UKZ bashkorganizator i manifestimit kulturor “Takimet e Dom Mikelit”, ka organizuar Konferencën Shkencore për Arbëreshët**

UKZ çdo vit organizon manifestimin kulturor “Takimet e Dom Mikelit”. Manifestimi letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Dom Mikelit” organizohet për çdo vit, si aktivitet përkujtimor për Mikel Tarabulluzin, klerikun dhe mësuesin, i cili në vitin 1905 e hapi shkollën shqipe në Stubëll.



*Konferenca Shkencore për Arbëreshët, shtator 2022*

## Konferenca Ndërkombëtare Ndërdisciplinore “Roli i teknologjisë në formësimin e shoqërisë” e cila u organizua nga UKZ



*Nga punimet e Konferencës “Roli i teknologjisë në  
formësimin e shoqërisë”, nëntor 2022*

## Doctor Honoris Causa

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan me nismën e Këshillit të Bizneseve të Rajonit të Gjilanit dhe pas vendimit të Senatit, ka nderuar me çmimin “Doctor Honoris Causa”, z. Lukas Mandl anëtar i Parlamentit Evropian.



Lukas Mandl Doctor Honoris Causa i Universitetit Publik “Kadri Zeka”, janar 2023

## Themelimi i Klinikës Juridike Penale

Fakulteti Juridik ka themeluar Klinikën Juridike Penale, ku për të promovuar klinikën i pranishëm ishte ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Sh. T. Philip S. Kosnett. Në Klinikë ofrohen shërbime të ndihmës juridike nga avokatë pro-bono (pa pagesë) të licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe studentëve të Klinikës Juridike Penale me raste reale. Ky aktivitet realizohet nga UKZ gjatë organizimeve, “Orët për ndihmë juridike pa pagesë”.



*Gjatë vizitës së Ambasadorit Philip Kosnett në UKZ*

## Krijimi i Klinikës Juridike me raste reale

Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan, përkatësisht Fakulteti Juridik, me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it “Drejtësia Vlen” dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, ka krijuar “Klinikat juridike me raste reale”.



*Gjatë organizimit të Klinikës Juridike me raste reale*

## BORDI INDUSTRIAL I BIZNESEVE

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, në vitin 2018, në takim me përfaqësues të Institucioneve komunale, kompanive dhe bizneseve, që veprojnë në rajonin e Anamoravës ka themeluar Bordin Industrial të Universitetit.



*Nga takimi me BI*

### **Panairët e punës**

Një hap me rëndësi është bërë në marrëdhënie me tregun e punës dhe me bizneset. Fakulteti Ekonomik ka organizuar panairin e punës “Ndërtojmë partneritet!”.



*Gjatë panairit “Ndërtojmë partneritet”*

Universiteti “Kadri Zeka” çdo vit merr pjesë në Panairë të Punës dhe Karrierës, duke prezantuar punën, aktivitetet dhe të arriturat e tij.

### **Themelimi i klubeve të UKZ-së**

Me qëllim të avancimi sa më adekuat të studentëve për tregun e punës, për të fuqizuar udhëheqësit e së nesërmes, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan ka themeluar Klubin e IT-së dhe ka në themelim Klubin e Debatit, Klubin Letrar dhe Klubin e Matematikanëve.



### *Aktivitet i Klubit të Debateve*

Klubi i IT-së, fuqizon udhëheqësit e së nesërmes për të ofruar zgjidhje për problemet e teknologjisë aktuale në vend me metoda të reja dhe më efektive.






*Aktivitet i Klubit të IT-së*

## **Ekspozitat në UKZ**

Studentët e Fakultetit të Edukimit, programi Arsimit Fillor dhe Arsimit Parashkollor, në organizime të ndryshme të Universitetit, nën udhëheqjen e profesorit të artit Ahmet Ibrahim, prezantojnë punime dhe krijime të tyre përmes ekspozitave.



*Disa nga ekspozitat e organizuara në UKZ*

## Kori i Universitetit

UKZ ka themeluar Korin e Universitetit, i cili në çdo organizim dhe manifestim performon himnet dhe këngë që i përshtaten organizimit në udhëheqjen e profesoreshës Drita Kryeziu.



*Kori i UKZ-së*

## Festivali i Lojërave Universitare organizuar nga FSUK



## HISTORIKU I QEVERISJES SE UNIVERSITETIT

UKZ fillimisht është qeverisur nga Këshilli Themelues i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, i emëruar më 25.6.2013 nga MASHT.



*Këshilli Themelues Drejtues: (nga e majta) Arben Dërmaku, Naim Sylja, Ilmi Ramadani, Fitore Malaj, Avdullah Alija, Qemajl Mustafa, Naser Mrasori, Sabri Tahiri, Behlul Brestovci dhe Blerim Kamberi.*

Ky këshill e ka zgjedhur Prof. Ass. Dr. Arben Dërmakun kryesues të Këshillit dhe ushtrues detyre të rektorit të UKZ-së.



*Prof. Ass. Dr. Arben Dërmaku, kryesues i Këshillit Themelues të UKZ-së dhe u.d. i rektorit të UKZ-së*

Pas dorëheqjes së Arben Dërmakut nga detyra e kryesuesit të Këshillit Themelues dhe u.d. së rektorit Këshilli Themelues, në mbledhjen e mbajtur më 6.2.2015, zgjodhi Prof. Asoc. Dr. Naim Sylën për kryesues të Këshillit Themelues dhe u. d. të rektorit të UKZ-së.



**Prof. Asoc. Dr. Naim Sylë**

## ZGJEDHJET E PARA PËR QEVERISJEN E UKZ

Gjatë vitit 2015 janë mbajtur zgjedhjet e para të përgjithshme për udhëheqjen e UKZ-së.

Anëtarët e Këshillit Drejtues 2015: Fejzullah Krasniqi, kryesues, Arben Dërmaku, zv. kryesues, Fitore Malaj, Shpresa Qamili, Sadik Haxhiu, Mensur Neziri, Arben Sahiti.

Këshilli Drejtues, më 18 shtator të vitit 2015 zgjodhi Prof.Asoc. Dr. Bajram Kosumin rektorin e parë të UKZ.





*Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, më 18 shtator të vitit 2015, zgjidhet rektor i parë i UKZ-së.*



*Foto, nga e majta: Prof. Ass. Dr. Naim Mustafa, prorektor për buxhet dhe financa, Prof. Ass. Dr. Shpresë Qamili, prorektore për mësim, kërkime shkencore dhe Çështje të Studentëve, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor, Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka, prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Mr. Sc. Vaxhid Sadriu, Sekretar i Përgjithshëm*





*Në foto, (nga e majta): Prof.Asoc. Dr. Januz Dervodeli, Dekan i Fakultetit të Edukimit, Prof.Ass. Dr. Gëzim Tosuni, Dekan i Fakultetit Ekonomik, Prof.Asoc. Dr. Bajram Kosumi Rektor, Prof.Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi, Dekan i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, Prof.Asoc. Dr. Sadik Haxhiu, Dekani i Fakultetit Juridik*

Parlamenti Studentor i dalë nga zgjedhjet e para të vitit 2015, pas konstituimit të Këshillit Studentor, sipas planit operativ të zgjedhjeve: Mehmet Zylfiu – kryetar, Blerina Ajvazi – sekretare, Festim Biqku – anëtar, Doruntina Hajdari – anëtar, Dritor Mehmeti – anëtar, Liridona Sabedini – anëtar, Fjolla Hajdari – anëtar.



*Foto PS, (nga e majta): Rrezart Rexhepi, Fatmir Kastrati, Arlind Ajvazi, Liridona Sabedini – anëtare e PS, Doruntina Hajdari – anëtare e PS, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Mehmet Zylfiu – kryetar i PS, Prof. Ass. Dr. Shpresa Qamili prorektorë, Blerina Ajvazi – sekretare e PS, Dritor Mehmeti – anëtar i PS, Fjolla Hajdari – anëtare e PS, Adian Bajrami.*

## ZGJEDHJET E DYTA TË PËRGJITHSHME NË UKZ

Në vitin 2019 janë organizuar zgjedhjet e dyta të përgjithshme në UKZ. Këshilli Drejtues, në kryesinë e z. Emrush Thaçi, dhe anëtarë Nevrije Ismajli, Merxhan Avdyli, Artan Haziri, Urtak Hamiti, Musa Ajeti, Violeta Abazi-Huruglica dhe Yllka Behluli, në shtator të atij viti zgjodhi Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumin edhe për një mandat rektor.



*Në foto nga e majta: Musa Ajeti, Artan Haziri, Yllka Behluli, Emrush Thaçi, Bajram Kosumi, Nevrije Ismajli, Merxhan Avdyli, Urtak, Vaxhid Sadriu*



Prof. Asoc. Dr. Xhevdet  
Thaqi, prorektor  
për mësim, kërkime  
shkencore dhe çështje të  
studentëve



Prof. Ass. Dr. Bajram  
Fejzullahu, prorektor për  
buxhet dhe financa



Prof. Asoc. Dr. Dukagjin  
Leka, prorektor  
për bashkëpunim  
ndërkombëtar



Vaxhid Sadriu, sekretar i  
përgjithshëm



Prof. Asoc. Dr. Merxhan  
Avdyli, dekan i  
Fakultetit të Edukimit



Prof. Asoc. Dr. Sadik  
Haxhiu, dekan i  
Fakultetit Juridik



Prof. Ass. Dr. Xhevat  
Sopi, dekan i Fakultetit  
Ekonomik



Prof. Asoc. Dr. Artan  
Dermaku, dekan i  
Fakultetit të Shkencave  
Kompjuterike



Prof. Ass. Dr. Shpresë  
Qamili, dekane e  
Fakultetit të Shkencave  
Aplikative

*Gjatë takimit të Këshillit Drejtues të UKZ-së, 2023. Anëtarët e Këshillit Drejtues të zgjedhur nga Senati i UKZ-së janë: Prof. Ass. Nerxhivane Krasniqi, Prof. Asoc. Dr. Urtak Hamiti, Prof. Ass. Dr. Selim Daku dhe Prof. Ass. Dr. Nexhat Shkodra. Kurse anëtarët e emëruar nga MASHT janë: Ilir Gjinolli, Agron Hajdari, Arta Istrefi.*



*Në foto nga e majta: Urtak Hamiti, Selim Daku, Vaxhid Sadiu, Bajram Kosumi, Agron Hajdari, Ilir Gjinolli, Arta Istrefi Jahja, Nerxhivane Krasniqi, Nexhat Shkodra*

## Parlamenti Studentor i dalë nga zgjedhjet e dyta 2018:

Sara Keqmezi Kryetare e Parlamentit Studentor,  
Leurina Guda, Alena Shabani, Donjeta Shabani, Arbisa  
Krasniqi, Valisa Abdyli, Albina Behluli, Daut Mahmuti,  
Nektar Hoda, Gentrit Shkodra, Dafina Keqmezi,  
Erëmirë Aliu





## **Besar Rexhepi – student i diplomuar ne FSHK në UKZ:**

“Studimet nuk të përgatisin vetëm në aspektin akademik, por ato të japin shumë më shumë. Të formësojnë personalitetin, të ndihmojnë për të krijuar shoqëri dhe të jesh pjesë e një komuniteti ku mund të kontribuosh dhe të marrësh nga aty.

Që nga diplomimi në UKZ, në vitin 2019 në Shkenca Kompjuterike, tani e tre vite kam biznesin tim; një byro kreative që në fokus ka krijimin e identitetit vizual, brendit dhe zhvillimin e web-it. Një pjesë e suksesit tim padyshim që i takon UKZ, nga i cili kam marrë hapat dhe njohuritë që sot të kem mundësinë të kontribuoj në shoqëri në njërën prej fushave e cila ka një rëndësi të madhe në shekullin XXI. UKZ ka sjellë mundësi dhe ka bërë një punë të shkëlqyer me studentët që kanë pasur fatin të jenë pjesë e këtij institucioni.

Redaksia:  
Prof.Asoc. Dr. Merxhan Avdyli  
Prof.Ass. Dr. Flamur Maloku  
Phd. Cand. Fitore Malaj  
Msc. Minire Rexhepi  
Msc.Valmira Abdullahu



